Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

17.09.2018, Prishtinë,
Ref:14.06.2018\658-2018

Vendim i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj ankesës së Vlora Krasqinit kundër portalit Telegrafi

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës në mbledhjen e tij të mbajtur më 11 shtator 2018, shqyrtoi ankesën e Vlora Krasqinit kundër portalit Telegrafi lidhur me artikullin "Eksperiment social në Prishtinë: Reagimi i njerëzve kur u kërkohet një përqafim nga një fëmijë (VIDEO)", dhe mori këtë

V E N D I M

- Ankesa nuk miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se Portali Telegrafi e ka botuar më 02 qershor 2018, një video që është realizuar nga Telegrafi në bashkëpunim me Max Travel, në ditën ndërkombëtare të fëmijëve. Kjo video u quajt "Eksperimeni social" ku fëmijët kishin përgaditur disa vizatime për qytetarët, e prej tyre kërkonin nga një përqafim.

Ankesa pretendon se është shkelur Kreu VI, pikë 1, të Kodit të Mediave të Shkruara. Përkitazi me mbrojtjen e fëmijëve që nuk duhet të intervistojnë apo fotografojnë fëmijët nën moshë 18 vjeçare pa pëlqimin e prindit apo të ndonjë të mituri përgjegjës për fëmijën.

Portali Telegrafi në përgjigjen e tij ka dokumentuar se ka marrë leje nga prindërit e fëmijëve të përfshirë në këtë eksperiment se pas kësaj përformance nuk ka asnjë qëllim të palejuar.

KMShK nuk gjeti shkelje të Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës. Andaj, ankesa nuk u miratua.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës